



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA
DEPARTAMENTI I GJUHËS SLLAVO-BALLKANIKE



PROGRAMI MËSIMOR I LËNDËS
Përdorimi i Drejtë i Gjuhës Turke

Ngarkesa: 6 kredite; 60 orë mësimore; 30 leksione / 30 seminare

Semestri kur zhvillohet: Viti II / Semestri I

Lloji i lëndës: Lëndë e detyrueshme

Programi i studimit: Master - Mësuesi

Kodi i etikës: Kodi i etikës i UT-së (nenet 4, 6, 7, 9)

PËRMBLEDHJET DHE REZULTATET E TË NXËNIT:

Lënda përdorimi i drejtë i gjuhës turke është një lëndë e detyrueshme, me 4 kredite, që zhvillohet 5 orë në javë dhe shlyhet në fund të semestrit në formën e provimit. Lënda është e organizuar në leksione dhe seminare, zhvillon kompetencat gjuhësore të studentëve në gjuhën turke. Studentët fokusohen në rregullat kryesore morfologjike, sintaksore dhe leksikore të gjuhës turke, njihen me punimet e gjuhëtarëve turq dhe të huaj për gjuhën turke, ushtrohen nëpërmjet ushtrimeve të ndryshme drejtshkrimore, morfologjike, sintaksore dhe leksikore, njihen me standartet e shkrimit shkencor, modelin e esesë, artikullit etj.

Objektivat e përgjithshme lëndore:

- Të fokusohen në rregullat kryesore drejtshkrimore të gjuhës turke.
- Të njohin rregullat e harmonisë vokale dhe përjashtimet nga rregulli
- Të njohin dhe të përdorin rregullat morfologjike, sintaksore dhe leksikore të gjuhës turke

Objektivat specifike lëndore:

- Të njohë rregullat drejtshkrimore
- Të pasurojë të shprehurit duke lexuar punime të gjuhëtarëve turq dhe të huaj për gjuhën turke
- Të njohë dhe të përdorë drejt rregullat fonetike dhe përjashtimet nga rregullat
- Të njohë rregullat për fjalët e huaja të turqishtes të huazuara nga gjuhët e tjera arabe, perse dhe gjuhët perëndimore
- Të mësojë rregullat morfologjike të gjuhës turke për fjalët e prejardhura dhe fjalët e përbëra si dhe përjashtimet
- Të mësojë rregullat sintaksore të gjuhës turke
- Të mësojë dhe të përdorë drejt format e pashtjelluara foljore
- Të shkruajë ese
- Të mësojë rregullat e standartit të një shkrimi shkencor
- Të paraqesë citimet dhe literaturën në një shkrim shkencor ose në punimin e tezës së diplomës
- Të dëgjojë dhe të kuptojë konferencat e dhëna nga profesorë turq për gjuhën turke, për çështjet e përdorimit të drejtë të gjuhës turke.